

## **Fjalim i deputetes Albana Vokshi**

03.07.2023

Në ditët e fundit të qershorit është shpërndarë kalendari i miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, është ajo së cilës ju i referoheni, zonja Felaj. Ndërkohë, në faqen zyrtare të parlamentit gjendet kalendari i miratuar në Konferencën e Kryetarëve, që, në fakt, nuk ka lidhje fare me rendin e ditës apo me urdhrin e Lindita Nikollës për seancën e sotme.

Pra, ju e shkelët Rregulloren herën e parë, kur në kalendarin e punës vendosët që për tri institucione kushtetuese të diskutohej ditën e hënë, pra të hënë pas Javës së Gjelbër, kur në bazë të nenit 40/1 të Rregullores është për çështjet e zgjedhësve dhe nuk shkelet; e ka shumë të qartë Rregullorja!

Në pikën 3, thuhet: “Java e katërt kalendarike është në dispozicion të deputetëve dhe grupeve parlamentare për trajtimin e problemeve që kanë zgjedhësit në qarqe në zonat zgjedhore”.

Pika 4: “Kuvendi zhvillon punime në seancën plenare për diskutimin e çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit pasditen e së hënës, që pason javën...; katër orë”. Kjo mund të shkelet vetëm kur Kuvendi ka një çështje urgjente apo kërkesë për një projektakt me procedurë të përshpejtuar. Nuk kemi asnjë çështje urgjente dhe nuk kemi asnjë projektakt!

Ah, në qoftë se është urgjente, sepse ju e mbyllët, me urdhër të Edi Ramës, parlamentin për 2 muaj gjatë fushatës zgjedhore, sepse ju bezdiste sa herë që ne flisnim, sepse donit të mbyllnit zërin e opozitës, kjo nuk përbën çështje për të shkelur Rregulloren në mënyrë të vazhdueshme!

Rendi i ditës së sotme ka disa shkelje të Rregullores.

Në fakt, unë nuk pres nga ju, zonja Felaj, ta zbatoni Rregulloren, pasi ju sot nuk duhet të ishit fare në atë karrige. Do të kishte qenë në nderin tuaj të kishit dhënë dorëheqjen, për ndërhyrje në reformën në drejtësi apo në institucionet e drejtësisë.

Së dyti, keni vendosur pesë institucionet e drejtësisë, dhe zoti Balla sapo tha: “Uh, kemi bërë një gjë të re. I kemi bërë bashkë”. E çfarë është kjo? Keni bërë bashkë pesë institucione? Keni bashkuar kohën? Po ne nuk duam ta bashkojmë. Ne duam të flasim për secilin institucion të drejtësisë, sepse ka aq shumë problematika për të diskutuar.

Thoni se Konferenca e Kryetarëve ka miratuar 90-minutëshin. Ku e keni mbledhjen e Konferencës? Unë kam kërkuar, së bashku me grupin e deputetëve të Partisë Demokratike, të mblidhet Konferenca e Kryetarëve; e keni detyrim ta mblidhni!

Nëse miratohet, nëse kërkoni diskutim rast pas rasti për çdo raport, atëherë, po rast pas rasti, Konferenca e Kryetarëve duhet të mblidhet dhe të vendosim minutazhin.

“90 minuta” jo vetëm është tallje, por është skandal! (Bie gongu.)

90 minuta, pjesëtim për 140...